

MARK GURAKUQI

BIBLIOTEKA
<i>BJH-32</i>
<i>p 96</i>

Minjera nuk

u mbyll



SHTËPIA BOTONJËSE SHTËTËRORE „NAIM FRASHËRI”

TIRANË 1951

8JH-32
8 96

9528-

MARK GURAKUQI

34377

R

Minjera nuk u mbyll



SHTEPIJA BOTONJESE „NAIM FRASHERI“

TIRANE 1951

MINIERA NUK U MBYLL

I

Pjetri atē natē ishte i çqetësuem. E ndjente zemrën tē angushtueme. I dukesh se diçka i ishte mbledhë lamsh nē fyt e donte me i marrë frymë. Thithte me fuqi cingaren e trashë sa gishti i nxirrté shtullungat e tymit, shpejt e shpejt, me furi, si ta kishin ato fajin. Por fajin e kishte dikkush tjetér. Pjetri e dinte mirë. E i viñte me plasë nga marazi, se s'kishte ç'të bante.

Undal nē breg tē Fanit. Lumi rrithte rrëmbyeshëm, i frymë nga shiu, qì kishte ra me rrshekë per dy ditë me rradhë. Ndën dritën e hanës ai shihte trungjet e pemëve, qì rrjedha e lumi i tèrhiqte me furi. Zhurma qì bante uji perzihesh me ate tē punëtorëve, tē cilët, atje sipër, nē klub, i a kishin fillue kangës.

Ishin tē gëzue ata. Tē gëzue, se s'dijshin mirë se si shkojshin punët. S'dijshin se, ndoshta, mbas pak ditësh, klub do tē mbyllesh, ashtu si miniera, e, nē kët rrah, s'do tē ndihesh ma fishkullimi i sirenës, zhurma e fonderisë, e vagonave. Asgja. S'dijshin, si ai, se, ndoshta, jeta, mbas pak ditësh, do tē shuente zanin nē ket vend, ku, ai e shokët e tij — tē gjithë — vjetë me radhë kishin derdhë kaq mund dhe djersë.

Tue mendue kështu, ndiu nji tē therun nē zemër. E pa vëten tue u endë nē nji vend tjetér, lark këtyne anëve, qì s'i ndrron te me asgja nē botë, lark Fanit, qì ishte aqë i dashua për të, e, mbi tē gjitha, lark minierës, qì do tē pushtonte së jetuemi bash atëherë kur kishte fillue tē punonte si donte ai, atëherë, kur ai e shokët e tij kishin andërrue ta bajshin ma tē madhe e ma tē frytshme, tē hapshin puse dhe galerina tē reja. T'i hyjshin tokës thellë nē zemër, jo ma pesdhetë, shtatëdhetë metra, por njiqind, njiqind e pesdhetë, dyqind, e tē nxirrshin nga gjini i saj sa ma shumë bakér.

Në klub filloj muzika.

Pjetri u shkund mendimesh, e, mekanikisht, iu **ngjit** fajes së kodrës. I bani shkallët e **ngurta** ngadalë, si plak. Hyni mbrendë. Ishin grumbullue ma shumë se dyqind vetë. Po hiqshin valle. U printe Saliu, drejtori i minierës. S'ishte ma në lule të rinisë, por kërcente për qejf.

Saliu e pa, i bani shej me dorë qì t'afrohet, të kërcente edhe ai. Pjetri s'e kishte mendjen te këcimi, por s'ia prishi.

Si mbaroi vallja, punëtorët u ulën rrëth tryezave. Disa prej tyne kishin mbetë në kambë.

Pjetri shkoi e u ul në tavolinë të Drejtorit. Me te, ishte dhe shefi i planit. Atje, nga e majta, pa Leksin, sekretarin e Partisë, qì ishte shtrue në muhabet me punëtorë.

Pranë tavolinës së tyre, qëndrojshin specialistët jugosllavë. Inxhinjeri, Bozhidari, qì rrinte në Tiranë e rrallë vinte në minierë, e "teknikët" Brankoja, Jovani, bashkë me "ate shpirtin e keq", si quente Pjetri, Brahi-nin, kosovar, qì e kishin prumë me vehte.

Pjetri vu re se Brankoja ishte dejë e bamë brryl. Herë mbash here, ngrente gotën me venë dhe bertiste: "zhiveo", e, pastaj, me të madhe, "zhiveo drug Tito" 1) Por s'ia vente kush veshin. Pjetri e vu re me kënaqësi këte gjë.

Brankoja shpesh e shikonte me inat. Pjetri e vente re me bisht të syut. E ziente përbreda. E njihte mirë. Do të kishte dashë ta kapte për zverku për atë zverk të trashë si të derrit, e ta përplaste prej shkallëve te poshtë, në lum ta lente vrapi. Por s'bani za. Ata ishin "miq". Veçse i erdhë nji mendim. Të paktën këte do ta bënte. Le të ndodhë ç'të donte.

U ngrit, atëherë kur salla kishte ra në qetësi, e nji britëm entuziaste i doli thellë nga zemra:

— Nji urra të fortë për shokun Enver!

— Urra!

— Edhe nji herë!

— Urra!

— Edhe nji herë!

— Urraaaa! buçiti për të tretën herë ~~sallë~~.

E, atëherë, si të ndiqte mendimin e Pjetrit, nji punëtor, atje nga fundi i sallës, ia pat me të madhe;

1) Rroftë Shoku Tito.

— Nji urra tē forti pēr shokun Stalin !

— Urra, urra, urra — ushtoi klubı.

Jugosllavët pritën që ndokush tē brohorasë pēr Titon, por s'u adigjue gja. Atéherë Brankoja, me gotën e venës nē dorë, u ngrit nē kambë e thirri me sa fuqi qì kishte :

— Zhiveo drug Tito !

— Zhiveo — thirrën dy jugosllavët e tjerë e Brahimë. E edhe disa zane tē tjerë tē veçuem, por pa zemër.

Pjetri pëshpëriti :

— Këjo ashtë nji dackë pēr ta !

— Hesht — tha Saliu qortues — mund tē tē ndigjojnë.

Dhe, sikur tē mos kishte ndodhë gja, kapi tē shoqen pēr dore, i bani shej orkestrës që tē fillojë e nisi me këcye. Tē tjerë e ndoqën.

Pjetri e priti sa tē mbarojë vallja, pastaj i tha Saliut :

— Shoku drejtor, due me dolë pak me ty.

Ai e shikoi me kureshtje.

— Sonte ?

— Qëtash, po mujte.

— Eja nesër nadja, Pjetër, para se tē shkosh nē punë.

— Mirë, shoku drejtor.

Mbas pak, u ngrit. Vu re se Jugosllavët e ndoqën me sy deri sa doli. E, n'ata sy, ai pa urrejtje

II

Saliu atë ditë s'ë ndjekë Vlorën mirë. I dhimbëte kryet. Kishin ndejë deri vonë. Por s'ishte vetëm ky shkaku. Pjetri e kishte futë ndër mendime. Djalë i mirë. Ai e donte fort. E njihte prej vjetësh. Puna, mendimtë, fitoret e përbashkëta i kishin afrue. Saliu nē Pjetrin shihte njeriun e drejtë, pa zhigia, njeriun me dorë nē zemer, qì donte Partinë mbi tē gjitha, komunistin e ndërgjegjëshem pēr punën e tij. Disa vjetë përparrë nji fshatar i thjeshtë, tash përgjegjës turni. Ç'ndryshim i math ! Sa shumë kishte ecë përparrë Pjetri, sa e madje ishte fuqija edukuese e Partisë, sa mirë i kalit njerëzit ajo. Saliu e kishte kuptue që nē fillim : po tē punohesh me te, Pjetri dì tē shkonte shumë lark. Ia kishte thanë edhe Leksit, Sekretarit tē Partisë. Ky kishte qeshë :

— Té njejtēn gja desha me ta thanē unē ty — ishte pērgjegjē Leksi. E kam vu re, qysh se ka ardhë. Pjetri do tē japē shumē. Na perket ne komunistave tē kujdesemi pēr te.

Vecse ishte pak i rrëmbyeshëm, Pjetri. Këte e kishte. Ja, natēn e kaiueme, edhe pēr pak do tē kishte shkaktue nji skandal. Kush i duronte jugosllavët, pastaj! Apo s'e kishin gjuhën tē gjatë!

Nësa Saliu po mendonte kështu, u hap porta. Çoi kryet me nervozizëm. Ishte inxhinjeri jugosllav, Bozhidari. Ky s'i uroi as ditën e mirë, por, pa pyetë fare, pa e përshëndetë, shkoi e u ul nē karrigën nē tē majtë tē tryezës. Vijëzohesh qartë inati nē fëtyrën e tij.

”Kush e di se ç' do tē ngatérrojë” — mendoi Saliu me vehte. Mos ka ardhë pēr punën e mbramëshme?

I zgjati kutinë e cigareve. Bozhidari muer nji, e ndezi, e thithi dy a tri herë, e me nervozizëm, e shoi.

Saliu s'foli. Piste sulmin e inxhinjerit. Dhe ky s'e zgjati.

— Kam ardhë pēr skandalin e mbramëshëm — tna.

Drejtori ngriti shpatullat. Bozhidari e vu re.

— S'kuptoni? — pyeti tallës.

— Jo, me tē vërtetë, s'kuptoj gja.

Pa Bozhidarët nē fëtyrë. Gjithë muskulat e saj ishin tē ndëmë. Sytë e vegjël, me nji shikim çeliku, ishin gati tē mbyllun. Buzët e holla dridheshin lehtë.

— S'kuptoni, e? Po juu sqaroj unë, atëherë. Ai i mbramëshmi qe nji provokacion. E qartë?

Saliu s'u përgjegj menjherë. Ndezi ngadalë, i qetë, nji cilëgare, e thithi gjatë, e pastaj:

— Jo shumë e qartë, shoku inxhinjer.

— Të flasim ma qartë, atëherë. Ai pantor i juej, Pjetri, a si i thonë — la pa brohoritë, mbramë, me qëllim pēr Titon, kurse ju e dini fare mirë se pa ndihmën tonë...

”S'do tē mund tē ndërttoni socializmin” — shtoi me mend, i anatosun, Saliu. Këto ishin ifjalët që ndëgjonte përsë ditë prej tyne. Nji e më dy, po aty rrihte çekiqi. Por s'e la me vijue.

— E dij, e dij shoku Bozhidar, e dij. Por jam i mendjes se Pjetri s'e ka bamë me qëllim.

— Kështu? (Bozhidari ruhë vetullat?) Jeni tepër naiv.

Ose i menjcëm — shtoi. Por tē keni para sysk nji gja: s'asht e

para herē qi bisedojmē pēr at element. Ai asht antijugosllav, ja po juu them unē se ç'asht.

Po filloate historija e zakonshême.

— Ai asht zanē keq me Brankon — vijoi Bozhidari ai pērçmon punēn tonē. Kam ndigjue nga burime tē sigurtē (nga Brahim — mendoi Saliu) se u ka thanē punētorēve qi miniera munt tē punojē — bile edhe ma mirē — pa ndihmēn tonē kētu. E ju duhet t'a dini se kjo asht e pamundun, krejt e pamundun.

Qi Pjetri kishte thanē kështu, e dintē edhe Saliu. Por po t'ia pohonte Bozhidarit, do t'i kishte nxjerrē mjaft ngatérresa. Mund tē shkontakte puna gjatē.

— Unē s'kam ndigjue gja — u pērgjegj.

— Sikur shumē e mbroni kêt katundar — tha inxhinjeri me pērçmim.

— Unē s'mbroj asnjeri nē mēnyrē tē veçantē, asnjeri, shoku Bozhidari. S'mē kanē vu kētu pēr kête.

— Sidoqoftē — tha kērcēnueshēm Bozhidari — unē do tē lajmēroj, pēr ngjarjen e mbramishême, organet kompetente.

Dhe u çue. Doli jashtē, pa i dhanē dörēn, pa e pērshēndetē, ashtu si kishte hymē.

“ Njè djall tē veç ” — mendoi Saliu.

Kapi, pa dijtē as ai vetē se ç'bante, letrat qì ishin grumbuillue mbi tavolinē. Filloi t'i lexojē, pa i kuplue. Dridhesh nga inati.

“ Do tē ngatérrojnē ndonjisend. Do tē ngatérrojnē, pa tjetē, ndonjisend. Sa pēr ngatérresa tē vetmit janē.

Ra porta. Hyni portjeri.

— Ka ardhē Pjetri. Don me folē me ju a tē vinē ?

— Shtine, shtine mbrendē.

Pjetri hyni ashtu truphedhun, me hapa tē mēdhej. Sytē i kishte tē ajun. Dukesh se kishte fjetē shumē pak. Kête Saliu e vu re menjherē.

— Nadja e mirē, shoku Drejtor.

— Mirē se vjen, Pjetēr. Ulu.

Pjetri nguli sytē nē fëtyrē tē drejtorit. Rallē, shumē rrallē, e kishte painē aq tē çqetësuem.

— Shoku Sali, filloi, por u ndal.

— Ç' ke Pjetēr, folē !

— Mē duket se s'je mirē sot !

— Ashiu asht, Pjetér s'jam mirē.

Drejtori muer rrigen qı kishte pérpara, e suell něpér duer pér nji copē kohē. Pastaj, e la mbi tryezē, hapi nji syzē, e mbylli, kapi pěrséri rrigen. Si u kujtue, e la muer kutinē e duhanit qı e mbante gjithnji mbi tavolinē, i dha nji cigare Pjetrit, ia ndezi, ndezi dhe nji vetē.

— Pak pérpara teje ishte kētu inxhinjeri jugosllav. Pjetér filloj Saliu.

Kétij i xixélluen sytē.

— E pashē kur po kalonte něpér korridor, tanē huj ishte.

— Ndigoj, Pjetér, ai m'u ankue pér ty, pér punē e mbraměshme.

— A ktue veç e paska pasē hallin, a? Pěrralla kazanash! Ata donē me gjetē halē ně perpeq.

Saliu e shikoi qortues.

— Pjetér, mos i merr kēto punē pér lojē. Ai mundet me ta bamě tě keqen. E jo vetém ty.

Pjetri s'u pérmbajt ma.

— Ndigoj, shoku Sali. Unē pér ket punē kam ardhē me folē me ty. S'mundem ma. Do ta shtroj edhe n'organizatē. Ti mě njeh. Unē tě kam fort pér zemēr. Ti e Leksi mě keni bamě njerēs.

— Jo ne, Pjetér, por Partija.

— Ani mitē. Partija. Ti i Partisē je. Leksi sekretar i Partisē asht. Partinē njerēzit e bajnē. Njerēs, tě mirē, tě drejtē si ju. Heshti pér nji ças.

— Shoku Sali, — vijoi — s'mundem ma. Due, me shkue me bisedue edhe me Leksin. E kěrkova, por s'e gjeta. Kishte shkue pér punē, ně Rrēshen. Ata thonē se kanē ardhē me na ndihmue, se janē miqt tonē. Mirē, miqt na i dona, i'nderojmē fort. Por nji kēta qı kena kētu, me ca mě duket mue, ně punē tě tyne kanē hile. Ndoshta kēta kanē qillue tě kēqij, unē s'tham se tě tanē janē kështu. Popujt jugosllavē, si ne, perpara kanē hekē dreqin e mallkue, por njita, veç, s'mě duket gja. Po ti a s'i sheh njiherē si sillen me punētorēt, a? Si italjant. Këte s'e them veç unē, po tě tanē, dikush haptē e dikush nepér dhambē. Ata bajnē kētu si me kenē ně shtepi tě vet, si ta kishin minierēn tě tynen. E ajo s'asht e tynja, por e jona, shoku Sali. Ti e din ma mirē se unē. Ne e měkambēn minierēn. E kishte mbulue uji. Tě kujtohet?

Qeshi.

— Sa i marrë qì jam! S' ka se si mos të të kujtohet! Ti pùnove bashkë me ne për nxjerrjen e ujit. Tre muej me radhë. E, mbasandaj, hapëm pusat, galerinat e reja, me duerët tona, me mundin t' onë. E me punën e mundin e inxhinjerave Sovjetikë. S'kam me e harrue kurrë inxhinjerin e minierës Kovaçenkon, e as at tjetrin, të fonderisë, Kuvinovin. Miq? Ata ishin miq të vërtetë, miq pa halë, shoku Sali. Ata janë miqt tonë të vërtetë. Kurrë s'u përzinë në punët tona, por gjithmonë qenë gati me na dhanë kskillë e ndihmë. Jo si këta shakllabanat qì kena këtu, qì fusin hundët kudo.

Saliu kishte ndejë e ndigjonte në heshije. Fjalët e Pjetrit ishin të drejta. Ai e dinte.

— E dij, Pjetër — tha — ke hak. Por duhet me u matë. Punët s'kan me shkue gjithmonë kshtu, s'kanë si shkojnë gjithmonë kështu. Kij besim në Partinë.

Pjetrit i ndriti fëtyra.

— Shoku Sali — tha — ti e the vetë ma parë. Partija më nxorri në dritë. E jo vetëm mue, por qinda, mijë të tjerë si unë, qì përpëra kishin mbetë në terr. Unë kam besim në te. E due. Po a ke ndi, mor burri i dheut, se ç' kanë nisë me thanë këta këtu? Thonë se miniera do të mbyllët, se s' qet gjia, se s' ka madem. Punëtorët flasin gjithnjë për kët punë. E kanë fillue mos me punue ma si përpëra. Kur e dijmë se kena me ikë, ça të lodhena kot. Jo të tanë, por mjaft prej tyne. Kështu s'mund të shkojë ma puna.

Saliu e dinte se këtu ishte gishti i inxhinjerit dhe i teknikëve jugosllavë. Ata i kishin përhapë këto fjalë, me ndërmjetësinë e Brahimit. S' do mend, qì kjo gjendje s'mund të vijonte.

— Ndigjo, Pjetër, kët punë e kena marrë në shqyrtim edhe në Byro. Do ta bisedojmë edhe në mbledhjen e organizatës. Por puna s' pret. Leksi e shokët e tjerë të byrosë janë të mendimit se duhet dalë nga kjo gjendje plogështije e sa ma shpejt. Puna duhet të vijojë. E, ta dijsh, sa ma mirë të punojmë, sa ma shumë të nxjerrim metal, aqë ma mirë do të jetë për të tanë. Miniera s' do të mbyllët, s' ka si mbyllët. Kam bisedue edhe me Nikën e me Ndoun. Ata më premtuën se në turnet e tyne do ta plotësojnë e do ta tejkalojnë normën. Këte duhet ta bajsh edhe ti në turnin

tand. Duhet nxitē dëshira për punë, duhen drejtue mirë punëtorët.
Kupton?

— Kuptoj, shoku Sali, kuptoj. Do të punojmë, si kurrë. Qe dorën.

Saliu ia shtrëngoi me dashuni, fort.

— Mirë, Pjetër — tha — shko tash. E kij mendjen, ?

— Mos u ban merak, shoku Sali.

E duel, me zemër disi të letueme.

III

Në klub, atë ditë kishte pak njerës. Ndok Shan Deda, sikurse sa herë që ishte i lirë, po luente domino me Llesh Frrokun.

Pjetri i vu re dhe buzqeshi. Çudi me njerëzit! Se ç' qejf kishin me ndejë me orë të tana e me luejtë domino!

Shkoi drejt tyne buzagas.

— Mirë se ju gjej, burra.

— Mirë se vjen, Pjetër. Ulu.

Pjetri filloi me pamë lojën, por jo me shumë vemendje. Me ndja i shkoi te Leksi, te drejtori, te jugosllavët, te miniera. Nji ndiesi angushtije e kishte kapë. Provonte ate ndjejë të njij njeriu që dashunon nji vajzë me gjithë zemër, asht marrosë pas saj, e ka të vetën, e ndien aqë afërt, deri aty ku s' vete ma, e asht në rrezik që t' ia shkëpusin nga duerët, ta humbë. Jetonte n' ankthim e dyshimit, të frikës, se mos ngjiste diçka që do t' i vente kapakuq çdo gjaje. E shihte anmikun të egër, në priti, të gatshëm me sulmues, nga të gjitha anët, e e ndiete vehten si të lidhun, kambë e duer, me nji fije të papame, në pamundësi me shtri duerët, më lëvizë. Donte me marrë frymë me u ngi me ajër të pastër, e dy duer i shtrëngojshin fytin, fort, fort, me sa fuqi që kishin. Si dy grremça, duer të nji përbindshi.

Miniera ishte jeta për te. E kishte pamë të rrithesh, të bahesh ditë e për ditë ma e frutshme, e kishte pamë me atë kënaqësinë që sheh prindi fëminë e vet, që për ditë bahet ma i bukur e ma i dashun. Si kishte qenë ajo më 1946, në Fruer, kur kishte ardhë ai! Gjermanët e kishin pasë rrenue. Zati fashistat shkatërrimin e e vdekjen kishin në zemër, jo jetën.

Pjetri s' ka me i harrue kurrë ato ditë. Puset ishin mbushë me ujë, galeritë, çdo gja. Pompat ishin të vogla; me to nuk mund